

NJOFTIM PËR SHITJE PËRMES ANKANDIT TË DYTË PUBLIK

Banka për Biznes njofton të gjitha subjektet e interesuara se përmbartuesi privat z. Shpend Ahmetaj me datë 29.02.2016, ka nxjerrë konkluzionin mbi shitjen publike të patundshmërisë së debitorit “**EDI SHPED NSH**” me seli në Pejë, përfaqësuar nga pronari **z. Hajriz Hasani**.

Në bazë të konkluzionit P.nr.215/15 të datës 29.02.2016 është caktuar shitja publike e patundshmërisë edhe atë:

- Sipas certifikatës së pronësisë nr. 721/12 në regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme, në sipërfaqe të përgjithshme 1132 m², ZK Istog me kulturë oborr dhe shtëpi banimi ngastra kadastrale nr. 72-12 fleta poseduese 117/2015, njësia kadastrale P -7080602000721-12 ZK Istog, vendi i quajtur Istog i poshtëm e evidentuar në emër të pronarit **Hajriz Hasani** nga Istogu në vlerë prej € 443,500.00

Në seancën e ankandit të dytë publik të shitjes, patundshmëria nuk mund të shitet me çmimin më të ulët se ½ e vlerës së përcaktuar të patundshmërive të lëna në hipotekë.

Vendi i shitjes: Zyra e përmbartuesit privat Shpend Ahmetaj, rr.“Mbretëresha Teutë, Objekti Semi Tronix, Pejë.

Data e shitjes: **28.03.2016, e Hënë.**

Koha e shitjes: **10:30h.**

Të drejtë pjesëmarrje në ankand kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat të cilët ofertojnë duhet të deponojnë në llogarinë e posaçme të përmbartuesit shumën prej 10% të vlerës së patundshmërisë por jo më shumë se € 5,000.00 para se të filloi seanca.

Depozita do t’iu kthehet ofertuesve të pasuksesshëm menjëherë pas ankandit.